

**pARadOKSiZMi – RRYMA MË E
FUNDIT LETRARE, ARTISTIKE DHE
FILOZOFIKE, PARAROJA E
MIJËVJEÇARIT TË DYTË**

Përkthyer në gjuhën shqipe nga:

Lediana Paja

Lidhja Ndërkombëtare e Poetëve , Shkrimtarëve dhe Artistëve
“PEGASI” ALBANIA

[From the book: **NonPoems**, by Florentin Smarandache, Xiquan Publishing House, Phoenix, Chicago, 1991, 1992, 1993; the volume contains very experimental so called, such as:

- poems without verse;
- poems without poems;
- poem-drafts;
- drawn-poems;
- poems in Pirissanorenoch (language spoken in the South-West of the United States by a single person);
- super-poems;
- graphic poems;
- upset-poems.]

A) Përcaktimi:

Pradoksizmi është një lëvizje praktike në letërsi, art, filozofi, shkencë bazuar në përdorimet e tepruara të antitezës, antinomisë, kontradiksionit, shembëltyrës, mosmarrëveshjes, anti-klisheve, derivimit të sensit, kundra fjalimeve, të pakuptueshmes, paradoksit, apo paradokseve të njëjta në krijime. U themelua dhe u udheheq nga Florentin Smarandache qe prej 1980, i cili u shpreh : “Qëllimi është zgjerimi i sferës artistike prej elementeve jo artistikë. Por sidomos kundra kohës, kundra kuptimit të krijimit. Është gjithashtu një eksperiment”.

B) Etimologjia:

Paradoksizmi = Paradox + ism, (pra paradoks+teori) që do të thotë teoria dhe shkolla e përdorimit të paradoksit në letërsi dhe në krijime artistike.

C) Historia:

Paradoksizmi filloi si një proteste antitotalitare kundër një shoqërie të mbyllur siç ishte Rumania e 1980, ku kultura e përgjithshme ishte e manipuluar nga një grup i vogël. Ishin vetëm idetë e tyre dhe botimet e tyre të numëruara. Ne nuk mund të botonim pothuajse asgjë.

Më pas unë thashë: “Le të bëjmë letërsi..., pa bërë letërsi. Le të shkruajmë..., pa shkruar aktualisht asgjë. Si? E thjeshtë: “Duke objektivizuar Letërsinë!” “Fluturimi i nje zogut”, përshembull, prezanton një “poezi natyrale”, që nuk është e nevojshme për t’u shkruar, duke qenë më i qartë dhe i dukshëm në çdo

gjuhë më tepër se disa shenja të hedhura në letër, që, në fakt, prezantojnë një “poemë artificiale” të deformuar, rezultat i një përkthimi të vëzhguesit në vëzhgim, dhe një përkthimi të fallsifikuar. “Makinat zhurmojnë në rrugë” ishte një “poemë e qytetit, “kositja e fshatarëve” një “poemë shpërndarjeje”, “ëndrra me sytë e hapur”, “një poemë surrealistë”, ‘fjalimet idiote” një “poemë dadaiste”, “Diskutimi në kinezce për një injorant të kësaj fushe” një “poemë Letriste (Dadaism+Surrealism)”, “diskutime të alternuara të udhëtarëve, në një stacion treni, në tema të ndryshme” një “poezi post-moderne (nder-tekstualism).

A do të dëshironit një klasifikim vertikal? “Poemë figurative”, “poemë superiore”, “poemë nuhatëse”, “poemë shijeje”, “poemë te prekshme”.

Një klasifikim tjetër diagonal: “poemë fenomenale”, “poemë shpirtërore – Statuti i shpirtit”, “poemë- çdogjë”.

Ne pikturë, skulpturë në mënyrë të ngjashme – të gjitha ekzistojnë në natyrë, të fabrikuar tashmë.

Megjithatë një protestë të heshtur bëmë ne!

Më vonë unë e bazova atë në kontradikcionin. Pse? Sepse ne jetuam në atë shoqëri një jetë me dyshime: zyrtare – të propaganduar nga sistemi politik, dhe një tjetër reale. Ne median masive ishte shpallur se jeta jone ishte e mrekullueshme, por në të vertetë, “jeta jonë ishte e mjerueshme”. Paradoksi ishte i mbarë! Atëherë ne e çuam krijimin në tallje, në kuptimin e kundërt, në një rrugë sinkretike. Atehere u lind paradoksi. Shakatë folklorike, në një modë të madhe në epokën e Çausheksut, si nje frymëmarje intelektuale, ishin burime të shkëlqyeshme.

“Jo”- të dhe “Kundra” nga manifestimi i paradoksit tim kishin një karakter krijues, aspak nihiliste (C.M.Popa). Kalimi nga paradokset në Paradoksizëm u dokumentua në përshkrimin e Titu Popesku në librin e tij klasik në lidhje me lëvizjen: “Azma e Paradoksizmit” (1994) Kur I. Soare, I. Rotaru, M. Barbu, Gh. Niculesku studiuuan Paradoksializmin në punën time letrare. N. Manolesku siguroi rreth një nga përmbledhjet e mia jo poetike, se ato janë kundra flokëve.

Nuk kisha dikë që të me frymezonte, por unë jam frymëzuar nga situatë me kokëposhtë që mbizoteronte në atë vend. Fillova që prej politikës, jetës sociale, dhe menjëhere mbërrita në letërsi, art, filozofi dhe madje dhe shkencë.

Mendova përmes eksperimentimit të sillja terma për një letërsi, art, filozofi apo shkencë të re, metoda te reja ose të paktën ndonjë alegori krijimi. Në një nga manifestimet e mia propozova sensin e përvetesimit, ndryshimin nga figurative në një kuptim të përshtatshëm, interpretimin e me kokëposhtë, si një interpretim shprehës gjuhësor. Në 1993 bëra një udhëtim paradoksal në shoqatat letrare dhe universitetet në Brazil. Brenda 30 viteve të ekzistences, 30 libra dhe 200 komente (artikuj dhe recensa) u publikuan, plus 5 antologji nacionale dhe internacionale ” (Florentin Smarandache)

D) E ardhmja e Paradoksializmit:

Teza base e Paradoksializmit:

Çdo gjë ka një kuptim dhe jo kuptimësi në harmoni me njëra - tjetrën

Esenca e Paradoksializmit:

a) sensi ka një jo sens, dhe reciprocikisht

b) jo kuptimësia ka një kuptimësi

#Motoja e Paradoksializmit:

“Çdo gjë është e mundur, e pamundur
gjithashtu”

#Simboli i Paradoksializmit:

(një spirale- iluzion optik, ose një rreth vicioz)

#Përcaktime të tjera pararojë:

- Paradoksizmi ka një kuptim, kur dadaizmi,
letrizmi, lëvizja absurde këtë s'e kanë;

- Paradoksizmi, sidomos tregon kontradiktat,
antinomite, antitezat, antifrazat, antagorismen, jo
konformizmin, paradokset në fjale të tjera të gjithçkaje
(në letërsi, art, shkencë), kur futurizmi, kubizmi,
surrealizmi, abstraksionizmi dhe të tjera drejtime nuk
fokusohen në to.

Drejtimet e Paradoksizmit

- Të përdorësh metoda shkencore (veçanërisht
alegorinë) për ta përgjithësuar (dhe studiuar
gjithashtu) letërsinë kontradiktore dhe punën
artistike;

- Të krijosh letërsi kontradiktore dhe një punë
artistike në hapësirën e shkencës (duke përdorur:
simbolet, shumëgjuhësinë, matricat, teoremat etj).

E) Manifestimi i tretë i Paradoksizmit

Prandaj, mos ushtroni ndonjë rregull letërsie tek
unë! Ose, nëse do ta bënit, unë do të shkel mbi ta. Unë
nuk jam poet, prandaj shkruaj poezi.

Jam një antipoet ose jopoet.

Kështu unë erdha në Amerikë për të rindërtuar versionin e Statujës së Lirisë, të derivuar nga tirania klasike dhe dogma e vet.

Unë lejova çdo guxim:

- Kundralettrarizmit dhe letraren
- Forma fleksibël të fiksuara, ose fytyrën e gjallë te vdekjes!
- Stilin dhe jo stilin
- Poema pa vargje (sepse poemat nuk nënkuptojne fjalë)- poetë memece me zë të lartë;
- Poema pa poemë (sepse nocioni “poema” nuk përkon me ndonjë kuptim të gjetur në fjalorë dhe enciklopedi) – poezi që ekzistojnë me mungesën e tyre;
- Letersinë e pasluftes: faqe që bombardohen me fëlliqësinë, mostrajtimin, dhe jo poetikisht;
- Version paragjyhesor (vetëm!): grafike, portrete lirike, vizatime, projekte...
- Poezi pa fjalë dhe pa sens
- Versionet shume të trishtuara dhe tepër hermetike
- Gjuha e kuptueshme dhe e pakuptueshme
- Ushtrime matematike të pazgjidhura dhe te hapura për zgjidhje si poezitë me të mira të shpirtit. Ne mund ta shkencërojmë artin në këtë teknikë shekulli.
- Tekstet personale të jopersonalizuara
- Shok elektrik
- Përkthimin nga e pamundur në e mundshme, ose transformimin e anormales në normale
- Pro artit pa art
- Të bërit letërsi nga gjithçka, te bërit letërsi nga asgjëja!

Poeti nuk është princi i rosave! Nocioni i “poezi”-së dhe derivateve të saj kanë dalë jashtë mode këtë shekull, dhe njerëzit qeshin me to pa respekt. Turpërohem, kur konfirmoj se kam krijuar tekste lirike, i fsheh ato. Njerëzit as i lexojnë, as i dëgjojnë tekstet lirike me, por do ta lexojnë këtë volum sepse s’ka asgjë për të lexuar!

Megjithatë, Lëvizja Paradoksishte, është ose nihilizem, ose ndryshim.

Libri jo-poezi është një protestë kundër marketingut të artit.

A i shisni ju shkrimtarë ndienjat tuaja? A shkruani vetëm për lekë?

Vetem libra rreth krimeve, seksit, tmerrit publikohen. Ku është arti i vërtetë? Duke lypur...

Ju do të gjeni në këtë libër, poezi të papërmbledhura, çdo gjë që nuk dëshironi dhe nuk e doni: poezi që s’mund të lexohen, që s’mund të dëgjoen, që s’mund të shkruhen fare!

Shijojini. Vetëm, pasi të bezdiseni, atëherë vërtet do ta kuptoni çfarë do të thotë kenaqesi.

Ato sigurojnë një pasqyrë te pafundesisë së shpirtit të çdokujt. Arti, në përgjithësi, është shtyrë deri në kufijtë e jo artistikes, dhe ndoshta më shumë.

Më mirë një libër me faqe të bardha, se sa një që s’thotë asgjë.

Një gjuhë shumë abstrakte dhe simbolike është përdorur me tej, por shumë konkrete në të njëjtën kohë: vargje jo strikte nga ndonjë formë apo përmbajtje. Merr avantazhin prej klisheve kundër vetes.

Çdo gjë është e mundshme, rrjedhimisht dhe e pamundshme gjithashtu! Prandaj mos u çudisni prej këtij antilibri! Nëse nuk e kuptoni, do të thotë se kuptoni gjithçka. Ky është qëllimi i manifestimit. Sepse arti nuk është për mendjen, por për ndienjat. Sepse arti është gjithashtu për mendjen.

Përpiquni të interpretoni të painterpretueshmen! Imagjinata juaj do të lulëzojë si një kaktus në shkretëtirë.

Por, Manifestimi Amerikan i Paradoksializmit është veçanërisht një revoltë e emigrantit në Shtetet e Bashkuara që nuk flet anglisht, kundra gjuhës – një libër i shkruar me një antigjuhë që është diçka me shumë se një anglishte e thyer (fjalimi amerikan i së nesërme ?)...

(Prej librit: *Jo Poezi*, nga Florentin Smarandache, Shtëpia botuese “Xinquan”, Phoenix, Cikago, 1991, 1992, 1993;

Volumi përmban eksperimente te ashtuquajtura si:

- Poezi pa vargje
- Poezi pa poema
- Projekte poetike
- Poezi ne pirisanorenc (gjuhë e folur në jugperendim te Shteteve të Bashkuara nga nje person i vetëm)
- Super poema
- Poema grafike;
- Poema të mërzitshme)